

K O N T R A T Ë

(P Ë R S H I T B L E R J E K U O T E)

E lidhur ne Tirane , sot, më datë 26.07.2018 (dymijeeshtatembedhjete), ndermjete palëve dhe kushtet e mëposhtme :

SHITËSI : **Zoti ILIR MINGA**, i biri i Mehmetit, i datelindjes 05.08.1964, lindur dhe banues ne Tirane , rruga “Irfan Tomini” Pall. 14 Ap.10, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit Nr.027912754 me Nr.personal G40805137E.

BLERËSI : **Zoti RENXO SHEHU**, i biri i Sokol, i datelindjes 19.12.1992, lindur dhe banues ne Tirane, rruga “Demokracia” Nd.404 H.5 Ap.5, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer 02848116 dhe numer personal J212190470.

Të cilët hartuan e nenshkruan këtë kontrate për shitblerjen e kuotes së kapitalin te shoqerise , si më poshtë vijon:

DUKE QENË SE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE:

Shoqëria tregtare e së drejtës shqiptare “PharmaCare Research & Consulting”Sh.p.k. është regjistruar në Regjistrin Tregtar, e pajisur me Nipt L81829015H , me seli ne Tirane ne rrugen “Njazi Demi” Nd.15/1 dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 1 **OBJEKTI**

Pala shitese shet dhe Pala Blerëse blen teresisht kuoten e zoteruar nga pala shitese e barabarte me 100% (njqind përqind) të vleres se kapitalit te regjistruar të shoqërisë tregtare “PharmaCare Research & Consulting”Sh.p.k. , duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga transferimi i pronësisë.

NENI 2 **KUSHTET**

Kuota, objekt i kësaj kontrate shit-blerje, shitet prej Shitësit dhe blihet nga ana e Blerësit në gjendjen në të cilën rezultojnë aktualisht nga librat e shoqërisë. Pala Blerëse deklaron se është në dijeni të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kalimi i pronësisë së kuotes dhe se i pranon ato ne gjendjen ne të cilën ndodhen, pa patur asnjë pretendim në lidhje me to.

NENI 3 **ÇMIMI**

Çmimi i ketij operacioni shitblerjeje përcaktohet, me marrëveshjen e përbashkët të palëve, në shumën 100.000 Lekë (njqindmije), te cilat jane shlyer teresisht nga pala blerese, duke ju paguar pales shitese.

NENI 4 **MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTES**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Shitëse humbet pronësinë mbi kuoten e kapitalit të Shoqërisë "PharmaCare Research & Consulting" Sh.p.k., duke mos patur më asnjë pretendim pronësie.

Në të njëjtin moment, Pala Blerëse bëhet pronare e kuotes së zotëruara nga Pala Shitëse në kapitalin themeltar të shoqërisë "PharmaCare Research & Consulting" Sh.p.k.

Pas realizimit të kësaj kontrate shitblerje, kuota e shoqërisë "PharmaCare Research & Consulting" Sh.p.k. do të zotërohet teresisht vetem nga zoti Renxo Shehu, i cili behet Ortak i Vetem i saj.

NENI 5 TË NDRYSHME

Për aq sa nuk është parashikuar në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që i referohen kontratës së shitblerjes dhe për sa përputhen me objektin e kësaj kontrate.


NENI 6 DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë hartohet në katër kopje të njëjta, ndër të cilat nga një kopje mbahet nga palët, një kopje depozitohet në QKB nga bleresi.


PALËT

SHITËSI



Ilir Minga


BLERËSI



Renxo Shehu
